

**VENDIM**  
**Nr.209, datë 26.2.2020**

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SPECIALE**  
**ANTI-KORRUPSION DHE ANTIEVAZION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ngritjen dhe funksionimin e Njesisë Speciale Antikorrupsion dhe Antievaizion (në vijim Njësia) si person juridik publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Njësia financohet nga buxheti i shtetit, burime të tjera të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi, si donacione vendase e të huaja, dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Misioni i Njesisë është koordinimi ndërmjet ministrave, institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit a ministrave, administratës së prefektit dhe shoqërive tregtare, me kapital pjesërisht a tërësisht shtetëror, me qëllim zbulimin, trajtimin dhe ndëshkimin e praktikave abuzive, korruptive apo arbitrare.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË NJËSISË**

4. Njësia ka këto funksione administrative:

a) Mbikëqyr veprimtarinë inspektuese të institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, për zbulimin dhe ndëshkimin e rasteve korruptive e abuzive;

b) Koordinon institucionet për nisjen e hetimeve administrative apo auditimeve, kryesisht, me indicie nga institucione publike apo me kërkesë të subjekteve të interesuara, në rast dyshimi për praktika korruptive, që lidhen me veprimtarinë e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi;

c) Mbledh, analizon dhe verifikon të dhëna e prova nga burime të ndryshme, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të përmbushjes së detyrave, për aq sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

ç) Referon praktikat korruptive dhe abuzive në prokurorinë kompetente, në rast dyshimi për konsumimin e elementeve të veprës penale;

d) Kryen verifikime dhe kontrolle pranë të gjitha institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, në funksion të garantimit të trajtimit dhe ndjekjes së rasteve korruptive apo abuzive;

dh) Kryen inspektime të përgjithshme apo tematike pranë institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, kur është e nevojshme;

e) Ndjek dhe zbaton detyrat e përcaktuara nga Komiteti Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Evazionit dhe e informon këtë të fundit për masat e marra kundër korrupsionit, ndjekjes së çështjeve dhe rasteve të dyshuara për korrupsion e paligjshmëri;

ë) Ofron shërbime këshillimi, të ekspertizës e të trajnimit, në bashkëpunim me institucionet publike e private, në seminare dhe takimet e punës për njohjen e legjislacionit në fuqi në fushën e parandalimit e të luftës kundër korrupsionit, si dhe promovon praktikat e mira;

f) Bashkëpunon me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion për ndjekjen, analizimin dhe trajtimin e praktikave korruptive apo abuzive.

5. Njësia do të përqendrohet në rastet korruptive, abuzive apo të shpërdorimit të strukturave të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- a) Administratë publike;
- b) Shërbime publike;
- c) Regjim i tokës (kompensimi, legalizimi, qiraja, koncesionet etj.)
- ç) Leje, licenca dhe autorizime;
- d) Prokurim publik;
- dh) Shkelje të mundshme penale në fushën tatimore dhe doganore.

6. Institucioni, që i nënshtrohet kontrollit apo verifikimit nga ana e Njesisë, ka për detyrë të vendosë në dispozicion të Njesisë të gjitha dokumentet dhe materialet e kërkuara ose kopje të njësuara me origjinalin e tyre në kohën dhe mënyrën e kërkuar. Në rastet kur ka pengesë ligjore për vënien në dispozicion të dokumenteve të klasifikuara, këqyrja dhe marrja e tyre bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

7. Institucioni, që i nënshtrohet kontrollit apo verifikimit, ka për detyrë të japë sqarime e shpjegime për çështje që lidhen me objektin e verifikimit apo të kontrollit si dhe për fakte e rrethana të tjera, që kanë lidhje me to, kur kërkohet nga Njësia.

8. Subjektet, veprimtaria e të cilave është nën verifikim, ftohen të japin sqarime e shpjegime për çështje që lidhen me objektin e verifikimit dhe për fakte e rrethana të tjera, që kanë lidhje me to. Shpjegimet dhe sqarimet mbahen me procesverbal, i cili nënshkruhet nga grupi i punës dhe subjekti. Grupi i punës, gjatë ushtrimit të detyrës, dokumenton çdo sqarim apo shpjegim që u jepet nga persona të tretë. Ballafaqimi i personave të tretë me subjektet mund të bëhet në rastin kur personat e tretë pranojnë dhe kur nuk kërkojnë t'u ruhet anonimat. Për mënyrën, afatet dhe kryerjen e verifikimeve zbatohen rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Njësia ka akses në bazat e të dhënave shtetërore, sipas nevojave të përcaktuara nga rekomandimet e Komitetit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Evazionit.

10. Në funksion të koordinimit ndërinstitutional dhe vendosjes së prioritetëve ngrihet Komiteti Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Evazionit, që ka në përbërje këta anëtarë:

- a) Kryeministrin;
- b) Ministrin e Drejtësisë;
- c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministrin e Brendshëm.

11. Me ftesë të Komitetit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Evazionit mund të marrin pjesë Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

12. Komiteti mbledhet me kërkesë të Kryeministrit, të paktën një herë në 3 (tre) muaj.

13. Njësia bashkëpunon me struktura të vendeve të tjera përgjegjëse për çështjet antikorruption, sipas marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim. Në këtë rast, marrëveshjet bëhen nëpërmjet ministrit të Drejtësisë.

14. Ministria e Drejtësisë, me qëllim zbatimin e këtij vendimi, nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme për ndjekjen e bashkëpunimit me Njësine për çështje të antikorruptionit dhe antievazionit.

### III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJËSISË

15. Njësia organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

16. Njësia drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Njesisë dhe përgjigjet përpara Kryeministrit. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Kryeministri.

17. Struktura dhe organika e Njesisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, dhe ka në përbërje edhe punonjës të institucioneve të varësisë së Kryeministrit,

Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me kohë të plotë ose të pjesshme.

18. Rregullat për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Njesisë miratohen nga drejtori i Përgjithshëm.

19. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të Njesisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

20. Rregullat për përzgjedhjen e punonjësve të Njesisë përcaktohen në rregulloren e brendshme të Njesisë, të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm. Punonjësit e institucioneve të tjera, me kohë të plotë ose të pjesshme, përcaktohen nga titullari përkatës, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion.

21. Punonjësit e Njesisë nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti dhe pajisen me certifikatë sigurimi të personelit, sipas legjislacionit në fuqi.

22. Punonjësit e Njesisë, përfshirë punonjësit me kohë të plotë nga institucionet e tjera, përfitojnë shtesë mbi pagë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa punonjësit me kohë të pjesshme përfitojnë shtesë mbi pagë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

23. Njësia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga Stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

24. Vula e Njesisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

25. Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë miraton manualët, procedurat dhe urdhrat e punës, që shërbejnë për përmbushjen e detyrave e të funksioneve të njesisë.

26. Ngarkohet Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion dhe të gjitha institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**